REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËS DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr.4, Tirane

PROGRAMI

I KURSIT TË VEÇANTË

"KARPENTIER"

(Kodi: K-20)

Miratoi

DREJTOR

.....

Tiranë, 2020

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

"KARPENTIER"

(Kodi: K-20)

I. Profili Profesional i Karpentierit.

a) Karakteristikat kryesore të Karpentierit.

Karpentieri do të jetë i aftë të kryeje punime të karpentierisë në ndërtesa dhe objekte të ndryshme ndërtimore. Ai do të angazhohet në detyra që kanë të bëjnë jo vetëm me shprehitë levizore të punës, por edhe me njohuri e sjellje të caktuara, të cilat mundesojnë ushtrimin me sukses të këtij profesioni. Për realizimin me sukses të detyrave të mësipërme, karpentierit i duhet që të zotërojë njohuri që kanë të bëjnë me materialet, veglat dhe pajisjet e ndryshme që përdoren në karpentieri, matjet e ndryshme, skicat e thjeshta të ndërtimit dhe karpentierisë, punimet kryesore të karpentierisë, llogaritjet e sasive të materialeve dhe shpenzimeve për to, rregullat e mbrojtjes në punë dhe ruajtjes sëmjedisit, dhe të shëndetit, e etj.
Suksesi i karpentierit në këtë profesion është i lidhur ngushtë dhe me sjellje (qendrime) të tilla si: të qënit i disiplinuar, i ndershëm, i durueshëm, me vullnet, gjakftohtë, korrekt, i kujdesshëm, sistematik, komunikues, etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë veshtirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit të "Karpentierit" dhe karriera profesionale e tij.

Profesioni i karpentierit është i lidhur ngushtë me punimet e karpentierisë të cilat kryhen në objekte që ndertohen dhe ristrukturohen. Kështu, karpentieri mund të punësohet në ndërmarrje (firma, kompani) ndërtimi apo ndërmarrje që kryejnë veprimtari për mirëmbajtje në fushën e ndërtimeve.
Karpentieri i ka mundësitë për të përparuar në profesion duke kaluar në faza të ndryshme profesionale si: ndihmës karpentier, karpentier, karpentier i kualifikuar, mjeshtër karpentier, teknik ndërtimi, inxhinier ndërtimi. Sigurisht që këto kërkojnë përvojë pune dhe arsimim e trajnim të vazhdueshëm.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për "Karpentier".

Në përfundin të Kursit për Karpentieri, kursantët do të jene të aftë të:

- përdorin skica dhe skema të thjeshta për të kryer punime të karpentierisë, në përputhje me to;
- përzgjedhin drejt dhe përdorin në mënyrë korrekte veglat dhe pajisjet e punës për të kryer punimet e karpentierisë;
- përzgjedhin drejt materialet e punës;
- kryejnë matjet dhe kontrollet e nevojshme për punimet e karpentierisë;
- përgatitin armatura prej druri dhe metalike për themelet butobeton, beton dhe betonarme;
- përgatitin armatura prej druri dhe metalike për kollona betonarme;
- përgatitin armatura prej druri dhe metalike për trarë betonarme;
- përgatitin armatura prej druri dhe metalike për soleta betonarme;
- përgatitin armatura prej druri dhe metalike për shkallë betonarme;
- përgatitin armatura prej druri dhe metalike për mure betoni dhe betonarme;

- bëjnë çmontimin e armaturave prej druri dhe metalike;
- kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për punime të karpentierisë;
- mirëmbajnë veglat dhe pajisjet e punës;
- garantojnë mbrojtjen në punë dhe ruajtjen e mjedisit dhe shëndetit gjatë punimeve të karpentierisë;

III. Kohëzgjatja e Kursit "Karpentier".

190 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

IV. Kërkesat e pranimit në Kursin "Karpentier".

Pjesëmarrësit në Kursin për Karpentier duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të shëndoshë fizikisht dhe mendërisht dhe në moshë mbi 16 vjeç.

V. Informacion për Modulet e Kursit "Karpentier".

Nr	Titulli i Modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e Karpentierit.	**K -01-20**	20 orë mësimore Rekomandohet: 60% Teori 30% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçorite e profesionit të karpentierit. 2. Kursanti përshkruan elementet kryesore të ndërtesës. 3. Kursanti përshkruan veglat, pajisjet e punës dhe materialet kryesore që përdoren në karpentieri. 4. Kursanti interpreton skicat e thjeshta të ndërtimit dhe karpentierisë. 5. Kursanti kryen matje dhe kontrolle në punimet e karpentierisë. 6. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në punimet e karpentierisë. 7. Kursanti kryen punime të materialeve drusore dhe metalike të karpentierisë.
2	Përgatitja e armaturës së drurit dhe metalike për themele betoni butobeton, betonarme.	**K -02-20**	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan armaturat (kallëpet) prej druri dhe metalike për lloje të ndryshme themelesh prej betoni, butobetoni, betonarme. 2. Kursanti përgatit armatura prej druri dhe metalike për themele betoni, butobetoni dhe betonarme.

3	Përgatitja e armaturës së drurit dhe metalike për kollona betonarme.	**K -03-20**	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan armaturat prej druri dhe metalike për kollonat betonarme. 2. Kursanti përgatit armatura prej druri për kollonat betonarme.
4	Përgatitja e armaturës së drurit dhe metalike për trarë betonarme	**K -04-20**	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan armaturat prej druri dhe metalike për trarë betonarme. 2. Kursanti përgatit armatura prej druri dhe metalike për trarë betonarme.
5	Përgatitja e armaturës së drurit dhe metalike për soleta dhe shkallë betonarme.	**K -05-20**	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan armaturat prej druri dhe metalike për soleta monolite,shkallë betonarme të llojeve të ndryshme. 2. Kursanti përgatit armatura prej druri dhe metalike për soleta monolite horizontale. 3. Kursanti përgatit armatura prej druri dhe metalike për soleta monolite të pjerrëta(rampa). 4. Kursanti përgatit armatura prej druri dhe metalike për shkallë betonarme.
6	Përgatitja e armaturës së drurit dhe metalike për muret beton dhe betonarme.	**K-06-20**	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan armaturat prej druri dhe metalike për muret betoni dhe betonarmeje. 2. Kursanti përgatit armatura prej druri dhe metalike per muret betoni dhe betonarmeje.
7	Çmontimi i armaturës së drurit dhe metalike.	**K-07-20**	10 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan procesin e çmontimit të armaturave prej druri dhe metalike. 2. Kursanti çmonton armatura prej druri për elemente ndërtimore betoni dhe betonarmeje.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.
Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për "Karpentier":

1. Moduli "Hyrje në profesionin e karpentierit"

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	**HYRJE NË PROFESIONIN E KARPENTIERIT.**	**K-01-20**
Qëllimi i modulit	Një modul teorik- praktik që i njeh kursantët me objektet, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së karpentierit, me veçorite dhe kerkesat e këtij profesioni, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit dhe shëndetit, si dhe i aftëson ata për të interpretuar skica të thjeshta të ndërtimit, për të kryer matjet e nevojshme në karpentieri, si dhe për të kryer punime të prerjes, montimit dhe çmontimit të materialeve drusore të karpentierisë.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë Rekomandohet: 60% **T**eori; 30% **P**raktikë dhe 10% **V**lerësime	
Kërkesat e pranimit	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar; të jenë të shëndoshë fizikisht dhe mendërisht; të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) , procedurat e vlerësimit.	**RM 1**	**Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të karpentierit.** ***Kriteret e vlerësimit:*** Kursanti duhet te jetë i aftë***:*** - të rendisë detyrat dhe punimet e karpentierit; - të përshkruajë mjedisin dhe kushtet e punës së karpentierit; - të përshkruajë kërkesat e profesionit të karpentierit; - të tregojë mundësitë e perparimit në profesionin e karpentierit. ***Instrumentet e vlerësimit*** - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim
	RM 2	**Kursanti përshkruan elementet kryesore të ndërtesës.** ***Kriteret e vlerësimit:*** Kursanti duhet te jetë i aftë***:*** - të tregojë se ç'janë ndërtesat dhe llojet kryesore të tyre; - të përshkruaje themelet dhe tregojë funksionet e veçoritë konstruktive të tyre; - të përshkruajë traret betonarme, kolonat betonarme , dhe muret prej betoni dhe betonarme;

- të përshkruajë muret dhe tregojë llojet, funksionet e veçoritë konstruktive të tyre;
- të përshkruajë soletat (ndërkatet) dhe tregojë funksionet e veçoritë konstruktive të tyre;
- të përshkruajë çatitë dhe tregojë funksionet e veçoritë konstruktive të tyre;
- të tregojë ç'janë hapësirat për dyer e dritare dhe përshkruajë veçoritë konstruktive të tyre;
- të përshkruajë shkallët, funksionet dhe veçoritë konstruktive të tyre;
- të përshkruajë ballkonet e llozhat, funksionet dhe veçoritë konstruktive të tyre.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje – përgjigje me gojë
- Pyetje – përgjigje me shkrim

RM 3 Kursanti përshkruan veglat, pajisjet dhe materialet kryesore që përdoren në karpentieri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë*:*

- të dallojë materialet, veglat dhe instrumentet që përdoren në karpentieri;
- të tregojë përdorimet e veglave dhe instrumenteve që përdoren ne karpentieri;
- të tregojë vetitë dhe përdorimet e materialeve që përdoren ne karpentieri;
- të tregojë standardet e materialeve për punimet në karpentieri;
- të përshkruajë skelat, llojet, ndërtimi dhe përdorimi i tyre;
- të përshkruajë rregullat e ruajtjes së materialeve për punime në karpentieri;
- të përshkruajë rregullat e ruajtjes dhe kujdesit për materialet që përdoren për karpentim.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje - përgjigje me goj
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 4 Kursanti interpreton skicat e thjeshta të ndërtimit dhe karpentierisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë***:***

- të tregojë kuptimin e simboleve të ndryshme që përdoren për skicat e elementeve të ndërtesës;
- të shpjegojë shënimet teknike në skicat e ndërtimit;
- të interpretojë shënimet e përmasave në skicat e ndërtimit;
- të tregojë veçoritë e paraqitjeve skematike të armaturave të drurit dhe metalike.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 5 Kursanti kryen matje dhe kontrolle në punimet e karpentierisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë***:***

- të tregojë cilat janë matjet dhe kontrollet që kryhen në punimet e karpenterisë;
- të tregojë njësitë matëse për matjet e karpenterisë;
- të dallojë dhe përdorë instrumentet dhe mjetet matëse-kontrolluese të karpenterisë;
- të kryejë matje të sakta me metër;
- të kryejë matje të sakta të vëllimeve të materialeve të drurit;
- të bëjë kontrolle të sakta të horizontalitetit dhe vertikalitetit, me nivel dhe mastar;
- të bëjë kontrollin horizontal me tub uji;
- të bëjë kontrolle të sakta të vertikalitetit me pe-plumç;
- të përshkruajë masat për ruajtjen e instrumenteve dhe mjeteve matëse-kontrolluese.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 6 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit dhe shëndetit në punimet e karpentierisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë***:***

- të përshkruajë kompletin e veshjes së karpentierit;
- të tregojë rregullat e sigurimit teknik në punimet e karpentierisë;
- të dallojë mjetet mbrojtëse në punimet e karpentierisë;
- të tregojë si jepet ndihma e parë për të dëmtuarit në punë
- të përshkruajë masat për ruajtjen e mjedisit gjatë punimeve të karpentierisë;
- të tregojë pasojat nga mos-respektimi i rregullave të sigurimit teknik e mbrojtjes se mjedisit dhe shendetit.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 7 Kursanti kryen punime të materialeve drusore dhe metalike të karpentierisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë***:***

- të kryejë matje të sakta dhe shënimet e duhura në materialet drusore dhe metalike të karpentierisë;
- të realizojë prerje të materialeve drusore me sharrë dore;

	- të realizojë prerje të materialeve drusore me sharrë elektrike; - të bëjë montimin e qëndrueshëm të elemeneteve të armaturave prej druri dhe metalike; - të bëjë çmontimin e aramturave prej druri dhe metalike; - të tregojë kujdesin e duhur për veglat e pajisjet e punës; - të respektojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit dhe shëndetit gjatë punimit të materialeve drusore dhe metalike të karpentierisë. ***Instrumentet e vlerësimit*** - Pyetje - përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli
Udhëzime për zbatimin e modulit.	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë dhe në sheshin e punimeve të ndërtimit. Rekomandohet që të bëhen vizita në objekte ku kryhen punime të karpentierisë. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të çështjeve që trajton. - Rekomandohet që instruktori të pajisë kursantët me materiale të shkruara, skica, udhëzuesa, rregullore, etj., në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. - Kursantët duhet të nxiten që të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë aktivisht në lidhje me problemet që trajtohen në modul. - Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet me tepër theksi te interpretimi i njohurive, koncepteve dhe fenomeneve të trajtuara, se sa te riprodhimi mekanik i tyre.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit.	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: - Klasë për mesimin teorik. - Shesh për punime të ndërtimit. - Skela të ndryshme. - Kompleti i veglave dhe pajisjeve të karpentierit. - Instrumentet dhe mjetet matëse-kontrolluese të karpentierit. - Materiale pune për karpentierinë. - Pankarta, skica, makete, udhëzuesa, rregullore, etj. - Materiale të hkruara në mbështetje të çështjeve të modulit.

2. Moduli "Përgatitja e armaturës së drurit dhe metalike për themele betoni, butobetoni dhe betonarme".

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	**PËRGATITJA E ARMATURES SË DRURIT DHE METALIKE PËR THEMELE BETONI, BUTOBETON DHE BETONARME.**	**K -02-20**
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik, që i njeh kursantët me llojet dhe veçoritë e armaturave prej druri dhe metalike për themele butobeton, betoni dhe betonarme, dhe i aftëson ata për të përgatitur këto lloj armaturash prej druri dhe metalike.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% **T**eori; 80% **P**raktikë; 10% **V**lerësime	
Kërkesat e pranimit	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar; të jenë të shëndoshë fizikisht dhe mendërisht; të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë përmbushur modulin" Hyrje në profesionin karpentierit".	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit.	**RM 1**	**Kursanti përshkruan armaturat (kallëpet) prej druri dhe metalike për lloje të ndryshme themelesh prej betoni, butobeton, betonarme.** ***Kriteret e vlerësimit:*** Kursanti duhet të jetë i aftë***:*** - të rendisë llojet e themeleve të ndërtesave; - të përshkruajë karakteristikat e themeleve prej betoni/butobeton/ betonarme; - të interpretojë skemat konstruktive të armaturave prej druri dhe metalike për themele betoni/butobeton/ betonarme; - të dallojë materialet që përdoren për ndërtimin e armaturave prej druri dhe metalike për themele betoni/butobeton/ betonarme; - të dallojë veglat dhe pajisjet e nevojshme për ndërtimin e armaturave prej druri dhe metalike për themele betoni/butobeton/ betonarme; - të dallojë llojet e skelave që përdoren për armaturat(kallëpet);

- të shpjegojë matjet, shënimet dhe kontrollet që kryhen gjatë ndërtimit të armaturave prej druri dhe metalike për betoni/butobeton/ betonarme;
- të rendisë hapat e punës për ndërtimin e armaturave prej druri dhe metalike për themele betoni/butobeton/ betonarme;
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit dhe shëndetit gjatë ndërtimit të armaturave prej druri dhe metalike për themele betoni/butobeton/ betonarme.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje-përgjigje me shkrim

RM 2 Kursanti përgatit armatura prej druri dhe metalike për themele betoni/butobeton/ betonarme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë***:***

- të interpretojë drejt projektin ndërtimor (planin themeleve).
- të njihet me vendin e punës;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për përgatitjen e armaturës prej druri dhe metalike për themele betoni/butobeton/ betonarme;
- të bëjë transportimin e mjeteve dhe materialeve në vendin e punës;
- të bëjë kontrollin paraprak dhe parapërgatitjen e themeleve të hapura;
- të kryejë matjet e sakta dhe shënimet e duhura në materialet drusore dhe ematlike për armaturën e themelit prej betoni/butobeton/ betonarme;
- të bëjë prerjen në përmasat e duhura të materialeve drusore;
- të përgatisë skelën sipas standarteve;
- të bëjë vendosjen në vendet e duhura dhe nguljen e binarëve orientues;
- të përforcojë binarët;
- të bëjë vendosjen e duhur dhe mbërthimin e mirë të dërrasave horizontale;
- të bëjë lyerjen me vaj të aramaturës së drurit dhe metalike;
- të bëjë nivelimin e saktë horizontal dhe vertikal të elementeve të armaturës së drurit dhe meatlike për themele betoni/butobeton/ betonarme;
- të fiksojë në mënyrë të qëndrueshme (me pyka ose flutura) elementet e armaturës prej dërrase dhe metalike;
- të bëjë kontrollin përfundimtar të armaturës prej dërrase dhe metalike për themele betoni/butobeton/ betonarme;
- të mirëmbajë veglat dhe sistemojnë materialet mbas mbarimit të punës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për

	përgatitjen e armaturave për themele betoni/butobeton/ betonarme; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të ruajtjes së mjedist dhe shëndetit. ***Instrumentet e vlerësimit*** - Pyetje - përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli
Udhëzime për zbatimin e modulit.	- Ky modul duhet të trajtohet në sheshin e punimeve të ndërtimit. Rekomandohet që të bëhen vizita në objekte ku kryhen ndërtime të armaturave prej dërrase për themele betoni. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të punimeve për ndërtimin armaturës prej prej druri dhe metalike për themele betoni, butobetoni dhe betonarme. - Rekomandohet që instruktori të pajisë kursantët me materiale të shkruara, skica, udhëzuesa, rregullore, etj., në mbështetje të punimeve që trajtohen në modul. - Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari praktike për përgatitjen e armaturës prej druri dhe metalike për themele betoni, butobetoni dhe betonarme. - Ata duhet të nxiten që të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë aktivisht në lidhje me aspektet teorike dhe praktike që trajtohen në modul. - Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet me tepër theksi te kontrolli i demonstrimit në praktikë të njohurive dhe shkathtësive të punës të fituara prej tyre.
Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit.	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Shesh për punime të ndërtimit të armaturës prej dërrase dhe metalike për themele betoni, ose objekt ku kryehen punime të tilla. - Kompleti i veglave dhe pajisjeve për përgatitjen e armaturës prej dërrase dhe metalike për themele betoni/butobeton/ betonarme. - Skela të llojeve të ndryshme. - Instrumenta matëse e kontrolluese. - Materiale drusore, metalike për armatura dhe materiale të tjera ndihmëse. - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa, rregullore, skica, plane themelesh, etj.

3. Moduli ”Përgatitja e armatures së drurit dhe metalike për kollona betonarme”.

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	**PËRGATITJA E ARMATURES SË DRURIT DHE METALIKE PER KOLLONA BETONARME.**	**K -03-20**
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i njeh kursantët me llojet dhe veçoritë e armaturave prej druri dhe metalike për kollona betoni (betonarmeje) dhe i aftëson ata për të përgatitur këto lloj armaturash prej druri dhe metalike.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% **T**eori; 80% **P**raktikë dhe 10% **V**lerësime	
Kërkesat e pranimit	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar; të jenë të shëndoshe fizikisht dhe mendërisht; të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë përmbushur modulin“ Hyrje në profesionin e karpentierit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit.	**RM 1**	**Kursanti përshkruan armaturat prej druri dhe metalike për kollonat betonarme.** ***Kriteret e vlerësimit:*** Kursanti duhet të jetë i aftë***:*** - të përshkruajë llojet, format dhe përmasat e kollonave betonarme; - të tregojë karakteristikat e kollonave betonarme; - të interpretojë skemat konstruktive të armaturave prej druri dhe metalike për kollona betonarme; - të dallojë materialet që përdoren për ndërtimin e armaturave prej druri dhe metalike për kollona betonarme; - të dallojë veglat dhe pajisjet e nevojshme për ndërtimin e armaturave prej druri dhe metalike për kollona betonarme; - të shpjegojë përdorimin e skelave që përdoren për punimet në lartësi; - të përshkruajë procedurat e matjeve, shënimeve dhe kontrolleve që kryhen gjatë ndërtimit të armaturave prej druri dhe metalike për kollona betonarme; - të rendisë hapat e punës për ndërtimin e armaturave prej druri dhe metalike për kollona betonarme; - të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të armaturave prej druri dhe metalike për kollona betonarme. ***Instrumentet e vlerësimit*** - Pyetje - përgjigje me gojë

- Pyetje-përgjigje me shkrim

RM 2 Kursanti përgatit armatura prej druri dhe metalike për kollonat betonarme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë***:***

- të interpretojë drejt projektin ndërtimor (planimetrine e kollonave, kollonat dhe prerjen e saj);
- të përgatitë vendin e punës;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për përgatitjen e armaturës prej druri dhe metalike për kollonën betonarme;
- të bëjë tansportimin e mjeteve dhe materialeve të duhura në vendin e punës;
- të bëjë kontrollin paraprak;
- të kryejë matjet e sakta dhe shënimet e duhura në materialet drusore dhe metalike për armaturën;
- të bëjë prerjen e materialeve drusore në përmasat e duhura.
- të përgatitë kornizën e poshtme;
- të bëjë lyerjen me vaj të armaturës së drurit dhe ato metalike;
- të bëjë vendosjen dhe montimin e armaturës se drurit dhe metalike në pozicionin vertikale;
- të përdorë siç duhet skelat për punime në lartësi;
- të vendosë në vendin e duhur elementet e armaturës së drurit dhe metalike;
- të bëjë nivelimin vertikal të elementeve të armaturës së drurit dhe metalike për kollonën e betonarmesë;
- të shtrëngojë dhe fiksojë në mënyrë të qëndrueshme, me qafore ose me binarë, elementet e armaturës prej druri dhe metalike;
- të bëjë përforcimin me pajanta (elemente të pjerrët), të armaturës prej druri dhe metalike;
- të bëjë kontrollin përfundimtar të armaturës prej druri dhe metalike për kollonën e betonarmesë;
- të mirëmbajë veglat dhe sistemojnë materialet mbas mbarimit të punës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për përgatitjen e armaturave per kollonat betonarme;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të ruajtjes së mjedisit dhe shëndetit.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit.

- Ky modul duhet të trajtohet në sheshin e punimeve të ndërtimit. Rekomandohet që të bëhen vizita në objekte ku kryhen ndërtime të armaturave prej dërrase dhe metalike për kollona betonarmeje.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të punimeve për ndërtimin armaturës prej druri dhe

	emtalike për kollonat betonarmeje. - Rekomandohet që instruktori të pajisë kursantët me materiale të shkruara, skica, udhëzuesa, rregullore, etj., në mbështetje të punimeve që trajtohen në modul. - Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari praktike për përgatitjen e armaturës prej druri dhe metalike për kollonat betonarme. Ata duhet të nxiten që të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë aktivisht në lidhje me aspektet teorike dhe praktike që trajtohen në modul. - Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet më tepër theksi te kontrolli i demonstrimit në praktikë të njohurive dhe shkathtësive të punës të fituara prej tyre.
Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit.	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Shesh për punime të ndërtimit të armaturës prej dërrase dhe metalike për kollona betonarmeje, ose objekt ku kryhen punime të tilla. - Kompleti i veglave dhe pajisjeve për përgatitjen e armaturës prej dërrase dhe metalike për kollona betonarmeje. - Skela të ndryshme. - Instrumenta matëse e kontrolluese. - Materiale drusore, materiale metalike për armatura dhe materiale të tjera ndihmëse. Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhezuesa, regullore, skica të armaturave dhe kollonave betonarme, etj.

4 Moduli "Përgatitja e armaturës së drurit dhe metalike për trarë betonarme".

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	**PËRGATITJA E ARMATURËS SË DRURIT DHE METALIKE PËR TRARË BETONARME.**	**K-04-20**
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i njeh kursantët me llojet dhe veçoritë e armaturave prej druri dhe metalike për trarë betonarmeje dhe i aftëson ata për të përgatitur këto lloj armaturash prej druri dhe metalike.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% **T**eori; 80% **P**raktikë; 10% **V**lerësime	
Kërkesat e pranimit	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar; të jenë të shëndoshe fizikisht dhe mendërisht; të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë përmbushur modulin "Hyrje në profesionin e karpentierit".	
